

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve U.O. dhe S.O., që të dy nga fsh. ...Komuna e Deçanit, për shkak të veprës penale lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 e nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit U.O., av. Isa Osdautaj, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.113/2018, të dt.18.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 19.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuara ankesa e mbrojtësit të akuzuarit U.O., av. Isa Osdautaj, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.113/2018, të dt.18.09.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.113/2018, të dt.18.09.2018, janë shpallur fajtor të akuzuarit:

- U.O., për shkak të veprës penale lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 e nënpar.1.4 dhe lidhur me nenin 31 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, kurse më pëlqimin e të akuzuarit konform nenit 47 lidhur me nenin 46 të KPK, të akuzuarit dënimi me burgim i zëvendësohet në dënimin me gjobe ne shumë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilin dënim është obliguar që ta paguaj në afat prej 60 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin më gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzet) euro, që i bie konkretisht 50 ditë burgim, dhe

- S.O., për shkak të veprës penale lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 e nënpar.1.4 dhe nenin 31 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, dhe më pëlqimin e të akuzuarit konform nenit 47 lidhur me nenin 46 të KPK, të akuzuarit dënimi me burgim i zëvendësohet me dënimin me gjobe ne shumë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilin dënim është obliguar që ta paguaj në afat prej 60 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin më gjobë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzet) euro, që i bie konkretisht 50 ditë burgim.

Janë obliguar të akuzuarit, që secili veç e veç që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej nga 50 (pesëdhjetë) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga 30 (tridhjetë) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej nga 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë mbrojtësi i të akuzuarit, U.O., av. I.O., për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda të i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, ose të pandehurit konform depozitës ligjore nga neni 393 pika 1.3, të shpallen të pafajshëm.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtrësën PPA/II.nr.1167/2018, datë 30.11.2018, duke u sqaruar përkritazi më ankesën e përbashkët të ushtruar nga të akuzuarit U.O. dhe S.O., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit U.O. av. I.O nuk është e bazuar

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit U.O., av. Isa Osdautaj, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke pretenduar se po qesë ka theksuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është tejet i lartë, dhe po qese vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.113/2018, të dt.18.09.2018, të mbrojturit të tij ti mundësohet ta paguaj me këste mujore prej 100 euro, për shkak se i akuzuari është pensionist dhe të ardhurat e tij janë të kufizuara, po ashtu edhe i akuzuari S.O., nuk është në marrëdhënie pune dhe si burim të vetëm jetësor e ka bujqësinë, ashtu që për të njëjtit është e pa mundur që shuma e cekur të paguhet brenda afatit prej 60 ditësh. Andaj, për arsye të lartcekura propozon si më lartë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave e të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimit, vjen në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes se vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila ju vihet në barë, se janë penduar se kanë kryer veprën penale, se më parë nuk kanë qenë të dënuar për ndonjë veprë ndonjë veprë tjetër penale si dhe premtimin që të ardhmen nuk do të kryejnë veprë tjetër penale, se janë të gjendjes së varfër ekonomike, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur, andaj, në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tyre, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Sipas vlerësimit të kolegjit të gjykatës së Apelit, sipas neni 55par.1 të KPPK, parashihet ‘*në një procedurë penale, mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje. Një mbrojtës nuk mund të përfaqësojë personin juridik dhe personin fizik në të njëjtin rast, përveç nëse personi fizik është i vetmi person që ka në pronësi, menaxhon dhe është i punësuar nga personi juridik,*’ që nënkupton se në këtë çështje penale ankesa e ushtruar nga ana e av. Isa Osdautaj, është trajtuar si ankesë e të akuzuarit të parë U.O., kurse nga shkresat e lëndës nuk ka autorizim që mund të i përfaqësoj të dy të akuzuarit, sikurse theksohet nga shkresat e lëndës.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.1163/2018 të datës 19.12.2018

B. profesionale
Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Shqipe Qerimi